

KRITEREVE DHE STANDARTEVE PËR KONTROLLIN ANTIPLAGJIATURË:

- a. Kriteret teknike (dixhitale) të përcaktuara në Manualin e përdorimit të Software-it të ofruar nga MASR.
 - b. Vërtetësinë dhe autenticitetin ligjor e shkencor të tekstit origjinal të disertacionit si kriter dokumentar:
- I. Nuk konsiderohen/vlerësohen si pjesë “të ngjajshme”, paragrafë të tillë si mëposhtë:
- a. Citime të çfardolloshme sipas gjithë manualeve përkatëse propozuar dhe aplikuar nga shkolla të ndryshme të shkrimit akademik, në trup të tekstit autorial apo në pjesë tjetër të faqes;
 - b. Perifrazime të adresuara në autorë, rryma apo shkolla mendimi teorik, praktik e shkencor, vendas e botërore, por jo të futura në thonjëza
 - c. Footnote;
 - d. Përdorimi i pjesëve të shkruara nga autori në botime të tjera paraardhëse (“self-plagiarism”)
 - e. Çdo rezultat “ngjajshmërie” që vjen nga: mosverifikimi i vitit të publikimit të një artikulli/dokumenti, mënyrës jo korrekte të përkthimit, pamundësisë teknike të verifikimit të dokumenteve të skanuara , pamundësisë teknike të verifikimit total të tekstit të “doktoraturës” apo publikimeve të tjera, pamundësisë së verifikimeve të tabelave dhe grafikëve, si dhe cdo arsye tjetër teknike dixhitale që nuk lidhet me qëllimshëmrinë për plagjiaturë të autorit.
 - f. Çdo pjesë tjetër brenda tekstit autorial apo teksteve të cituara që evokon një të dhënë tjetër me karakter universal historik, shkencor apo teorik të gjithë pranuar në çdo kohë nga gjithë komuniteti shkencor i një fushe të caktuar;
 - g. Çdo paragraf tjetër që autori argumenton me fakte se nuk është ngjajshmëri, por pjesë logjike e arsyetimit të tij shkencor në rastin e publikimit përkatës;
 - h. Pjesët hyrëse, (introduktet), prologët epilogët , bibliografia, bibliografi apo burime të tjera që janë përdorur nga autori në funksion të shtrimit dhe vërtetimit të hipotezës/tezave shkencore dhe kthimit të saj / tyre në kontribut origjinal autorial shkencor.

- II. Procesi i kontrollit antiplagjiaturë të respektojë standartin e përcaktuar në dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 24/2012, ndryshuar me Ligjin nr.120/2014 “PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE”.
- III. Konsiderohen studim plagjiaturë ato disertacione të përdorura për marrjen e gradës shkencore , tek të cilat “ngjajshmëria” e kalon kufirin mbi 25%, në raport me pjesën autoriale origjinale të disertantit.
- IV. Universiteti “Eqrem Çabej” për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve të përdorura për marrjen e gradës shkencore ndjek dhe respekton kriteret dhe standartet e mëposhtme:
- a. **Kriteret teknike** (dixhitale) të përcaktuara në Manualin e përdorimit *Softëare-it* të ofruar nga MASR.
 - b. Vërtetësinë dhe autenticitetin ligjor e shkencor të tekstit origjinal të disertacionit **si kriter dokumentar**:
- V. Nuk konsiderohen si pjesë të “ngjajshme”, paragrafë të tillë si mëposhtë:
- a. Citime të çfardolloshme sipas gjithë manualeve përkatëse të propozuara dhe aplikuar nga shkolla të ndryshme të shkrimit akademik, në trup të tekstit autorial apo në çdo pjesë tjetër të faqes;
 - b. Perfrazime të adresuara në autorë, rryma apo shkolla mendimit teorik, praktik e shkencor, vendas e botërorë por jo të futura në thonjëza;
 - c. Footnote;
 - d. Përdorimi i pjesëve të shkruara nga autori në botime të tjera paraardhëse (“self-plagiasm”).
 - e. Çdo rezultat “ngjajshmërie” që vjen nga : mosverifikimi i vitit të publikimit të një artikulli/dokumenti, mënyrës jo korrekte të përkthimit, pamundësisë teknike të verifikimit të dokumenteve të skanuara, pamundësisë teknike të verifikimit të tabelave dhe grafikëve, si dhe çdo arsye tjetër teknike dixhitale që nuk lidhet me qëllimshërinë për plagjiaturë të autorit;
 - f. Çdo pjesë tjetër brenda tekstit autorial apo teksteve të cituara që evokon një të dhënë tjetër me karakter universal historik, shkencor apo teorik të gjithëpranuar në çdo kohë nga gjithë komuniteti shkencor i një fushe të caktuar;
 - g. Çdo paragraf tjetër që autori argumenton me fakte se nuk është ngjajshmëri, po pjesë logjike e arsyetimit të tij shkencor në rastin e publikimit përkatës;

- h. Pjesët hyrëse (introduktet), prologët , epilogët, bibliografia, bibliografia apo burime të tjera që janë përdorur nga autori në funksion të shtrimit dhe vërtetimit të hipotezës/tezave shkencore dhe kthimit të saj/tyre në kontribut original autorial shkencor.
- i. Procesi i kontrollit antiplagjiaturë të respektojë standartin e përcaktuar në dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 24/2012, ndryshuar me Ligjin nr.120/2014 “PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE”.

VI. Konsiderohen studim plagjiaturë ato disertacione të përdorura për marrjen e gradës shkencore , tek të cilat “ ngjajshmëria ” e kalon kufirin mbi 25% në raport me pjesën autoriale të disertantit.

Kjo shtojcë i bashkëlidhet Kodit të Etikës miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 26. datë 08.09.2020

